



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prilato Received / Delivered	14.04.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br. Prot Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHK	2124/2022		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.196/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.196/2022 të datës 01.03.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit/Komuna e Malishevës, në çështjen juridike "transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.196/2022 e datës, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Aktvendimi me numër 01/273 i datës 25.02.2022 , i nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Malishevës lidhur me transferimin e ankuesit.

A r s y e t i m

Ankuesi është i punësuar në Komunën e Malishevës, sipas akt emërimit me numër Nr.01/84 të datës 11.01.2012 në pozitën "Zyrtar i prokurimit", në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme. Me datën 25.02.2022, Kryetari i Komunës së Malishevës, ka nxjerrë vendimin me numër 01/273, sipas të cilit ankuesin e ka transferuar përkohësisht në vendin e punës E-pasuria në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet, pas kërkesës me Nr.04/80 të datës 27.01.2022 të Drejtorit të Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa lidhur me caktimin e stafit për dy pozita në këtë drejtori për shkak të vëllimit të madh të punëve.

I pakënaqur me vendimin Nr.01/273 të datës 25.02.2022, të Kryetarit të Komunës së Malishevës lidhur me transferimin e përkohshëm në pozitën E-pasuria në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi,

Buxhet dhe Financa, me datën 01.03.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1093/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave ligjore, shkeljeve procedurale dhe vlerësimit të gabuar jo real dhe jo të plotë me gjendjen faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 14.03.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Malishevës. Ndërsa me datën 25.03.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesën e ankuesit nga Komuna e Malishevës, lidhur me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1093/2022 të datës 01.03.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktvendimin me numër 01/273 të datës 25.02.2022 lidhur me transferimin e ankuesit; Kontratën e punës së ankuesit me numër Nr.03/832 të datës 01.09.2003; Akt emërimit të ankuesit me numër Nr.01/84 të datës 11.01.2012; Certifikatën e avancuar profesionale për prokurim të ankuesit me numër Nr.215 e vitit 2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.03.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 25.03.2022 nga Komuna e Malishevës lidhur me shkresat e lëndës për ankuesin; Diplomën me numër Nr.705 të datës 08.04.2004 e ankuesit për përfundimin e studimeve në fakultetin juridik; Kërkesën me numër 04/80 të datës 27.01.2022 nga drejtori i drejtorisë për ekonomi, buxhet dhe financa për stafin shtesë lidhur me pozitat zyrtar për arkë dhe zyrtar për e-pasuri; Listën lidhur me pozitat në katalogun e vendeve të punës konkretisht për pozitën zyrtar i pasurisë; Dëshmi lidhur me shkaputjen nga rregullorja për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën zyrtar i e-pasurisë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit se për pozitën "Zyrtar i pasurisë" nëpunësi duhet të jetë i certifikuar dhe duhet të jetë i fushës së ekonomisë (ekonomist), Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ju referua Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e cila përcakton se kjo pozitë hyn në kuadër të grupit Specialist i Administrimit të Përgjithshëm, për të cilën kërkohet Arsimim i Lartë i Paspacificuar, po ashtu sipas nenit 33 paragrafit 1 dhe 2 nën paragrafit 2.4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, janë përcaktuar që: *"Pozitat në Shërbimin Civil grupohen sipas kategorisë, klasës dhe natyrës së pozitës. 2. Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.4. Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë"*, si dhe ndërlidhur me përshkrimin e detyrave të punës të po kësaj pozite, Kolegji ka konstatuar se nuk është ofruar asnjë dëshmi nga palët lidhur me atë se decidivisht kërkohet certifikatë specifike për kryerjen e punëve në këtë pozitë apo se nëpunësi të cilën e mban këtë pozite patjetër duhet të jete vetëm i fushës së ekonomisë. Po ashtu ndërlidhur me këtë çështje, Kolegji ka analizuar edhe Rregulloren MF-NR.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, konkretisht nenin 16 të po kësaj rregulloreje, ku parashihen edhe detyrat e Zyrtarit të pasurisë e që askund nuk përcaktohet se për këtë pozite nëpunësi duhet të jetë i certifikuar apo duhet të jetë me kualifikim vetëm nga fusha e ekonomisë, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me atë se i njëjti duhet të jetë i certifikuar për kryerjen e punëve në pozitën e lartcekur dhe se duhet të jetë ekonomist është i pa bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke ju referuar provave të lëndës dhe dispozitave ligjore në fuqi, ka konstatuar se kur institucioni vlerëson që është e nevojshme dhe për interes të institucionit mund të bëhet transferim i përkohshëm i nëpunësve civil, brenda të njëjtës kategori dhe gjatë dy viteve jo më shumë se gjashtë muaj siç parashihet me dispozitat e nenit 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili nënkupton që: *“Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve”*.

Bazuar në kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet të Komunës së Malishevës Nr.04/80 të datës 27.01.2020, e parashtruar ndaj Kryetarit të Komunës së Malishevës më të cilën ka kërkuar që për shkak të vëllimit të madh të punëve të mbështeten me staf shtesë për dy zyrtar, atëherë Kolegji ka vlerësuar se institucioni duke e parë të arsyeshme këtë nevojë ka bërë transferimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita “Zyrtar i prokurimit” në pozitën “Zyrtar për E-pasuri”, në pajtim me nenin 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 5 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, sepse në bazë të Vendimit me numër 01/237 të datës 25.02.2022 të Kryetarit të Komunës së Malishevës, ankuesi përkohësisht është transferuar në kategori të njëjtë dhe me koeficient të njëjtë dhe ndërlidhur me këtë veprim nuk i është cenuar asnjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës.

Bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nëpunësi civil mund të refuzojë transferimin në këto raste: kur gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur dhe nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se 100 km nga vendbanimi i nëpunësit civil, siç parashihet me nenin 52 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, i cili përcakton se: *“Transferimi i përkohshëm bëhet me afat të përcaktuar në vendimin përkatës për transferim dhe është i detyrueshëm, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 52. paragrafin 3 të Ligjit”*, në këtë rast nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet ligjore për refuzim të transferimit nga ana e ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me numër 01/273 i datës 25.02.2022 i Kryetarit të Komunës së Malishevës, për transferimin e përkohshëm përveç që është në pajtim me dispozitat ligjore të lartcekura, është në përputhje me nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me shkelje thelbësore të dispozita ligjore në fuqi, janë të bazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqenëse përmes Vendimit me numër 01/273 të datës 25.02.2022 të Kryetarit të Komunës së Malishevës për transferimin e përkohshëm të ankuesit është përcaktuar që transferimi bëhet deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve, atëherë pas përfundimit të afatit të transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme siç parashihet me nenin 52 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.196/2022, datë 13.04.2022

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMEFI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryetarit të Komunës së Malishevës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Malishevës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

